



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
PRODHIM MOBILJE SH.A
TIRANË

Adresa: Rruga e Kavajës, Ish-Kombinati i Drurit "MistoMame" E-mail: prodhim.mobilje@hotmail.com Tel.0682045455

Tiranë më 16/9/2020

MARRËVESHJE PËR BASHKIM ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE :
ALBTURIST T.O. SHA, AEROPORTI "NËNË TEREZA" SHA, NPV SHA DURRËS, PRODHIM
KABLO SHKODËR, KRIPA SHA VLORË, ELBER SHPK ELBASAN,
NGA PRODHIM MOBILJE SHA TIRANË

Bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", neni 216, dhe Vendimeve Nr 112-117, dt. 05/12/2019, të **Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë** në cilësinë e **Aksionarit të vetëm**, **Projekt/marrëveshjeve** të hartuara nga përfaqësuesit ligjor të shoqërive dhe publikuar në dt.15/07/2020 në QKB, hartohet **Marrëveshja për bashkim me përthithje** të shoqërive, ku shoqëria përthithëse është shoqëria "**Prodhim Mobilje**" sh.a. dhe shoqëritë e përthithura me të dhënat sipas tabelës më poshtë:

Nr	Emërtimi shoqërisë	Statusi sipas Marrëveshjes së bashkimit	NIPTI	Adresa	Përfaqësuesi Ligjor	Kapitali themeltar Lek
1	Prodhim Mobilje Sha	Shoqëria Përthithëse	J61827055V	Rr. e Kavajës Tiranë	Arban TARIFA	1,351,387,000
2	Albturist T.O. Sha	Shoqëria Përthithur	K31623038D	Rr. Kavajës Tiranë	Pavlina Konini	90,501,565
3	Aeroporti Nënë Tereza Sha	Shoqëria Përthithur	J61820023S	Rr. e Durrësit Tiranë	Fatmir Cibaku	2,769,890,000
4	NPV Sha	Shoqëria Përthithur	K71309502E	Rr.A.Goga L.18 Durrës	Gëzim Çullaj	73,893,000
5	Prodhim Kablo Sha	Shoqëria Përthithur	J66902025D	Z. Industriale Shkodër	Llazar Berati	938,200,000
6	ND/JA "KRIPA" Sha	Shoqëria Përthithur	J66703246N	L.Hajro Cakerri Vlorë	Besnik Demaj	17,167,569,000
7	ELBER Shpk	Shoqëria Përthithur	K13621201W	Lagja Dyli&Haxhire Myzyri,Ish NBSH Elbasan	Ledja Kollçinaku	83,000,000
	Kapitali themeltar pas bashkimit					22,474,440,565

Llazar Berati
Demp

Arban Tarifa

Fatmir Cibaku

Gëzim Çullaj

Llazar Berati

1

Ledja Kollçinaku

Administrator i shoqërisë përthithëse, “**Prodhim Mobilje**” sh.a., sipas shkresës Nr.23206/1 date 17.12.2019 dhe Vendimit të **Asamblese së Përgjithëshme** të Aksionerit Nr.127/1 datë 17.12.2019 është Arban TARIFA, *identifikuar sipas ligjit nëpërmjet Letërnjoftimit ID Nr. H40609105H e lëshuar ne datë 26.04.2018, i cili do të qëndrojë në detyre nga data : 17/12/2019 Deri : 17/12/2022.*

Për modalitetet e bashkimit të shoqërive u përpiluan raportet e përbashkët, të cilët u depozituan rregullisht bashkë me projekt marrëveshjet.

Për të kryer këtë mision dhe të gjitha modalitetet e bashkimit, sipas Vendimeve të Asamblesë së Përgjithëshme Nr.112-117, datë 05.12.2019, janë emëruar Ekspertët Kontabël e Regjistruar të cilët kanë hartuar (faza e parë e bashkimit) “Raportin e Bashkimit” i depozituar QKB dt 15/07/2020:

- **Aida MALOKU me NIPT K32612411T**, me Liçensë Nr. 55 datë 31.01.2000, Mobil: 0692063464 malokuaida@yahoo.com
- **Z.Lavdimir FUSHA me NIPT K92302060P** me Liçensë Nr. 97 datë 13.12.2000, Mobil: 0692067870 lavdimir.fusha@albanianaudit.com
- **Z.Neshat MAZE me NIPT K92302060P**, me Liçensë Nr. 148 datë 21.07.2005. Mobil: 067 20 79 155 ,E-mail lireng.auditing@gmail.com

Shoqëritë e përthithura sipas tabelës më lart do të kalojnë të gjitha pasuritë e tyre tek shoqëria “**Prodhim Mobilje**” sh.a.

Shoqëria përthithëse do të gëzojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që shoqëritë e përthithura kishin në momentin e përthithjes, përfshirë edhe ato tatimore sipas sistemit elektronik.

Me bashkimin e shoqërive, shoqëria përthithëse është pronare 100% e shoqërive të përthithura. Si rrjedhim raporti i pjesëmarrjes në aksione në shoqërinë përthithëse pas bashkimit do të jete si në nivelet e mëposhteme, përkatësisht:

- **Ministria Financës dhe Ekonomisë, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Numri i total i kuotave 22,474,440.565, me vlerë nominale 1000 (njëmijë) Lek.**

Me bashkimin e shoqërive, lind nevoja për ristrukturim e riorganizim të shoqërisë përthithëse, si pasojë e krijimit të një situatë të re ekonomike-financiare. Punonjësit që mund të dalin të tepërt nga ristrukturimi organizativ i shoqërisë së re do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

Organet e administrimit të shoqërisë përthithëse kanë po ato të drejta dhe detyrime që kanë gëzuar përpara bashkimit të shoqërive.

Shoqëria përthithëse “**Prodhim Mobilje**” sh.a. do të marrë në aktivin dhe pasivin e bilancit të saj, të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërive të përthithura sipas bilanceve të datës 31.12.2019 dhe të gjitha veprimet kontabël të kryera nga shoqëritë e përthithura gjatë vitit 2020 do të

regjistrohen në kontabilitetin e shoqërisë përthithëse, pra atë të shoqërisë **“Prodhim Mobilje” sh.a.**

Me miratimin e bashkimit me përthithje në QKB, palët duhet të kryejnë veprimet:

1. Dokumentacioni i zotëruar nga shoqëritë e përthithura deri në datën e miratimit të bashkimit nga QKB ti dorëzohet me Proces Verbal të rregullt shoqërisë përthithëse Prodhim Mobilje Sha Tiranë të cilat do të ruhen sipas afateve të përcaktuara ligjërisht.

2. Të dorëzohen tek shoqëria përthithëse Prodhim Mobilje Sha me Proces Verbal inventarët:

- Aktive Afatgjata Materiale
- Aktive Afatshkurtra Materiale
- Furnitorë
- Klientë
- Debitore / Kreditorë të tjerë

3. Të ndryshohet pronësia e mjeteve të transportit (në se ka) duke i kaluar te shoqëria përthithëse.

4. Të bëhet kalimi i llogarive bankare i shoqërive të përthithura tek shoqëria Prodhim Mobilje Sha.


5. Sipas sistemit elektronik tatimor Shoqëritë që përthithen rezultojnë me gjendje kreditore për TVSH dhe Tatim fitimi sipas tabelës më poshtë:

Tabela e të drejtave dhe detyrimeve tatimore për shoqëritë që do të përthithen nga Prodhim Mobilje Sha

nr	Emertimi Shoqërisë	Kërkesa ndaj tatimeve sipas SE dt 14/09/2020		Detyrime ndaj tatime SE dt 14/09/2020	
		TVSH për tu kthyer (Lek)	Tat. Fitimi mbipaguar	TVSH për tu paguar (Lek)	Tat. Fitimi për tu paguar (Lek)
1	Albturist T.O. Sha				
2	Aeroporti Nënë Tereza Sha	233,146,187	36,891,782		
3	Prodhim Kablo Sha	450,629	1,558,133		
4	NPV Sha				
5	ND/JA "KRIPA" Sha			19,969,720	1,313,170
6	ELBER Shpk	14,873,097			
	Shuma				

Palët të bëjnë rregullimet në **deklaratën tatimore në sistem** për periudhën kur ndodhi bashkimi me përthithje për gjendjen debitore - kreditore për TVSH dhe Tatim Fitimi.

Pala e përthithur duhet të sqarojë me shkrim arsyen dhe mënyrën e krijimit të kësaj gjendjeje deri në datën e përthithjes në shënime të analizave të llogarive kontabël.



Së fundmi “Palët” bien dakort që të autorizojnë Z. Arban TARIFA, –Administrator i shoqërisë përthithëse - të kryejë aplikimin në QKB për dorëzimin e dokumentacionit përfundimtar të procedurës së bashkimit me përthithje për të gjitha shoqëritë.

Përfaqësuesit Ligjor/Administrator

Për shoqëritë që përthithen

Pavlina KONINI

Fatmir CIBAKU

Gëzim ÇULAJ

Llazar BERATI

Besnik DEMAJ

Ledja KOLLÇINAKU

Për shoqërinë përthithëse

Arban TARIFA

